


**KONTAKTET**

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC),  
Zyra për Shqipërinë,  
Rruga Ismail Qemali, Nr. 27,  
Tiranë  
Tel: +355 4 2 23 29 28  
Faks: +355 4 2 23 29 28  
E-mail: ecani@rec.org

[www.sinphonie.eu](http://www.sinphonie.eu)  
[www.rec.org](http://www.rec.org)  
<http://albania.rec.org>

**Përmbajtja e studimit në terren**

Studimet e përgjithshme në terren do të zhvillohen gjatë periudhës Shtator 2011 - Mars 2012 dhe do të përfshijnë elementët e mëposhtëm:

**Monitorimi mjedisor:**

- Matjen e karakteristikave fizike, të ndotësve kimikë dhe të agjentëve biologjikë në ajrin e brendshëm në tre klasa të shkollave të përzgjedhura (dhe në ajrin e jashtëm në rrethinat e afërta). Kjo matje përfshin 18 parametra fizikë dhe kimikë (të tillë si formaldehida, dioksidi i karbonit, shkalla e ventilimit) paralelisht në ajrin e brendshëm dhe të jashtëm, matur nga ekspertët e mjedisit përmes pajisjeve të veçanta
- Kampionimin mjedisor për përcaktimin e mikrobeve dhe të agjentëve alergjikë (pluhuri në mjediset e brendshme etj.). Markerë të veçantë të llojeve të kërpudhave dhe baktereve do të maten në pluhurin që mbulon sipërfaqet.

**Vlerësimi shëndetësor:**

- Pyetësorët mbi gjendjen shëndetësore të fëmijëve dhe të mësuesve në shkollat e përzgjedhura. Pyetësorët për prindërit do të përmbajnë pyetje shtesë në lidhje me historinë mjekësore të familjes dhe mjedisin në shtëpi.
- Testet e spirometrisë do të zhvillohen nga ekspertët e shëndetit te të gjithë fëmijët në klasat e përzgjedhura. Testet do të realizohen vetëm me lejen e komitetit të etikës dhe me miratimin e prindërve.
- Testet e përqëndrimit/vëmendjes do të zhvillohen në klasa nga mësuesit dhe ekspertët e shëndetit përgjatë 15-20 minutave. Testet do të realizohen vetëm me lejen e komitetit të etikës dhe me miratimin e prindërve.

Testet e përqëndrimit/vëmendjes do të zhvillohen në klasa nga mësuesit dhe ekspertët e shëndetit përgjatë 15-20 minutave. Testet do të realizohen vetëm me lejen e komitetit të etikës dhe me miratimin e prindërve.

**Roli i stafit të shkollës**

Zbatimi në mënyrë të lehtë dhe efektive i aktiviteteve të lidhura me studimin varet nga bashkëpunimi imirëmidis stafit të shkollave të përzgjedhura dhe ekspertëve të mjedisit dhe të shëndetit.

Ajër i pastër  
fëmijë të shëndetshëm  
e ardhme më e ndritur



## Sfida mjedisore dhe shëndetësore

Lidhja ndërmjet gjendjes së mjedisit dhe ndikimit të tij në shëndet dhe në mirëqënie ka marrë një vëmendje gjithnjë e më të madhe në Europë që pas viteve 1980-të, kur vendet europiane ndërmorrën një proces për eliminimin e kërcënimeve më të mëdha mjedisore ndaj shëndetit të njeriut. Procesi frymëzuar nga konferencat ministrore, të cilat janë mbajtur çdo pesë vjet dhe janë organizuar nga Zyra Rajonale për Europën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OBSh Europë). Një arritje në proces ishte nënshkrimi i Deklaratës së Parmës për Mjedisin dhe Shëndetin nga shtetet anëtare të OBSh-së për Europën, në vitin 2010-të.

## Fokusi te shkollat

Mesatarisht, njerëzit në Europë shpenzojnë mbi 90% të kohës së tyre në mjediset e brendshme. Duke patur parasysh faktin se cilësia e ajrit të brendshëm, në përgjithësi, është më e keqe se cilësia e mjedisit të jashtëm, cilësia e ajrit të brendshëm ka një ndikim jashtëzakonisht të madh në cilësinë e jetës dhe të shëndetit.

Fëmijët dhe stafi i shkollës shpenzojnë pjesën më të madhe të ditës brenda ndërtesës së shkollës. Një mjedis i shëndetshëm në shkollë, si rrjedhojë, mund të përmirësojë drejtpërdrejt shëndetin e fëmijëve dhe të nxisë mësimin efektiv, duke ndihmuar kështu në zhvillimin e të rriturve të shëndetshëm dhe të aftë. Një cilësi e keqe e ajrit të brendshëm mund të rezultojë në probleme serioze shëndetësore të fëmijët, të cilët janë më të ndjeshëm se të rriturit ndaj efekteve të ndotjes së ajrit, por, gjithashtu, dhe mes mësuesve dhe anëtarëve të tjerë të stafit të shkollës.

Sot, më shumë se një në tre fëmijë europianë vuajnë nga astma bronkiale apo alergjitë dhe sëmundjet respiratore janë çdo vit në rritje, veçanërisht në Europën Qendrore dhe Lindore. Në këtë aspekt, ka nevojë urgjente për të adresuar ndotjen e ajrit të brendshëm në shkolla.

## Si e përball projekti SINPHONIE sfidën?

SINPHONIE (Ndotja në mjediset e brendshme të shkollave dhe shëndeti: Rrjet vëzhgues në Europë) është një projekt kompleks kërkimor që përfshin çështjet e shëndetit, të mjedisit, të transportit dhe të ndryshimeve klimatike, me qëllimin final përmirësimin e cilësisë së ajrit në shkolla dhe në kopshte. Projekti po zbatohet në kuadër të një kontrate shërbimi për Drejtorinë e Përgjithshme të Komisionit Europian për Shëndetin dhe Çështjet e Konsumatorit (SANCO).

Një numër total prej 38 institutesh të mjedisit dhe shëndetit, nga 25 shtete, marrin pjesë në projektin kërkimor SINPHONIE, duke punuar për reduktimin dhe parandalimin e sëmundjeve të aparatit të frymëmarrjes të shkaktuara nga ndotja e ajrit të brendshëm dhe atij të jashtëm. SINPHONIE bazohet në faktin se e drejta për të thithur ajër të pastër në shkolla është thelbësore në të drejtën për shëndet.

## SINPHONIE në veprim

Në kuadër të projektit SINPHONIE do të ndërmerren një sërë studimesh mjedisore dhe shëndetësore në terren dhe rezultatet do të analizohen duke përfshirë informacionin ekzistues mbi këtë çështje. Kjo do të çojë në një vlerësim gjithëpërfshirës të riskut lidhur me ndikimin e cilësisë së ajrit të brendshëm në klasa mbi shëndetin e fëmijëve dhe performancën e tyre.

Mjedisi në shkollë mund të preket nga një sërë faktorësh, përfshirë volumin e trafikut në rrethinat e afërta, metodat e ngrohjes dhe llojin e ventilimit (p.sh natyror apo mekanik). Të gjithë këta faktorë duhet të merren në konsideratë kur caktohet vendi, koha dhe metoda e matjes së ndotjes. Meqënëse mjediset përreth ndërtesës kanë ndikim të madh në cilësinë e ajrit të brendshëm, vendndodhja është një kriter veçanërisht i rëndësishëm në identifikimi e shkollave për studimet në terren. Si rrjedhojë, përzgjedhja duhet të përfshijë shkollat në zona të gjelbëruara, në zona me trafik të rënduar dhe në zona industriale, për të lejuar krahasimin.

Studimet në terren do të zhvillohen gjatë periudhës së dimrit, pasi ngrohja ka një ndikim të rëndësishëm në nivelet e ndotjes së ajrit të brendshëm.

Në përfundim të studimeve, do të përgatiten dhe rekomandimet për hartuesit e politikave, arkitektët, inxhinierët e ndërtimit, fëmijët dhe stafin e shkollave se si të përmirësojnë cilësinë e ajrit të brendshëm në shkollat europiane.

